



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 2

Prishtinë, më 28. 1. 2014, në orën 11.00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në këtë mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali – kryetare, Rita Hajzeraj – Beqaj, Biserka Kostiq, Kurtan Kajtazi, Albana Gashi, Justina Pula, Kymete Bajraktari dhe Kimete Bytyçi.

Mungoi: Duda Balje.

Nga Staf i mbështetës i Komisionit: Reshit Gashi - Koordinator dhe Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

Pjesëmarrës të tjerë: Sami Salihu-MPMS, Minire Begaj-MPMS, Nexhat Sylja-MPMS, Lejla Selimi-OSBE, Visar Bivolaku-EU OFFICE-EUSR, Nuredin Ibishi UNDP, Burim Tahiri UNICEF, Bujar Kadriu -Shoqata e të Verbërve, Agon Vrenezi-OHCHR, Sakibe Jashari-Ambasada e Zvicrane, Ibish Sylejmani- Shoqata e të Verbërve, Valdet Hajdini-Shoqata e të Verbërve dhe Edona Tolaj-YIHR.

Mbledhjen e kryesoi, Suzan Novoberdali- kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21.01.2014;
3. Ecuritë aktuale të zbatimit të Ligjit për Personat e Verbër. I ftuar për këtë pikë të rendit të ditës është ministri i MPMS, z. Nenad Rashiq;
4. Miratimi i Raportit të punës së Komisionit për vitin 2013;
5. Miratimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2014;
6. Formimi i Panelit Rekrutues për rekrutimin e kandidateve për zgjedhjen e Avokatit të Popullit;
7. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

Takimi filloj me pikën e tretë të rendit të ditës pasi që të ftuar ishin përfaqësuesit e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

3. Ecuritë aktuale të zbatimit të Ligjit për Personat e Verbër, i ftuar për këtë pikë të rendit të ditës është ministri i MPMS, z. Nenad Rashiq

Ministri i MPMS-së, i cili ka qenë i ftuar në këtë takim, nuk ka qenë prezent, mirëpo i ka deleguar përfaqësuesit e ministrisë me qëllim të dhënies së informatave të kërkuara nga ana e Komisionit.

Kryetarja – Pasi i përshëndeti të pranishmit i informoi se Komisioni është në procesin e monitorimit të Ligjit për personat e verbër dhe në takimin e kaluar kanë vendosur që të ftohet ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në mënyrë që t'i informojë me të dhënat e kërkuara nga Komisioni. Duke u ndërlidhur me procesin e monitorimit të ligjit ajo tha se është konstatuar se disa akte nënligjore të cilat sipas ligjit duhet të nxirren nuk janë nxjerrë. Ajo tha se Ligji i cili ka qenë i paraparë të zbatohet nga 1 janari i vitit 2013 nuk është zbatuar apo thënë konkretisht nuk janë realizuar pagesat për të verbëritë dhe përcjellësit e tyre, kurse sa i përket vitit 2014 ajo tha se këto pagesa kanë filluar të realizohen. Ajo konkretisht kërkoi informacione se si do të bëhet realizimi i atyre pagesave, sepse Ligji ua garanton të verbërve që në mënyrë retroaktive t'i marrin ato pagesa.

Sami Salihu – Në cilësinë e përfaqësuesit nga MPMS – ja theksoi se përgatitjet për zbatimin e ligjit kanë filluar vitin e kaluar më formimin e Komisionit Mediko – Social i cili në tetor dhe nëntor ka bërë ekzaminimin e palëve të cilët kanë aplikuar në këtë Komision, mirëpo me mungesën e mjeteve më vonë është ngadalësuar edhe tempo e ekzaminimit dhe deri më tani ata kanë ekzaminuar 732 raste, ku në kategorinë e parë bëjnë pjesë 529 persona, kategorinë e dytë 149 persona, kurse 52 raste janë refuzuar dhe

në pritje për ekzaminim janë edhe 958 raste. Lidhur me realizimin e pagesave të kësaj skeme ai i njoftoi anëtarët e Komisionit se këtë muaj ata kanë filluar me pagesën e kësaj skeme.

Minire Begaj – Duke u ndërlidhur theksoi se ata kanë bërë rishikimin dhe ndryshimin e Rregullores për Komisionin Mediko – Social në të cilën janë futur disa standarde të tjera të cilat ata kanë konsideruar se është e nevojshme. Lidhur me çështjet ligjore ajo tha se në muajin shtator të vitit të kaluar ata e kanë bërë një interpretim dhe kanë kërkuar evitimin e problemeve që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit, mirëpo nuk kanë marrë përgjigje dhe për këtë arsye ata kanë menduar që të bëhet plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit për të verbëritë. Lidhur me këtë ajo tha se stafi profesional dhe Kabineti i Ministrit kanë hartuar një koncept dokument për trajtimin e çështjeve të Ligjit për të verbëritë. Ajo tha se koncept dokumenti është hartuar, por për shkak të procedurave ata duhet të presin për miratimin e atij koncept dokumenti i cili i është dërguar Qeverisë për shqyrtim dhe miratim në fillim të muajit dhjetor 2013, por ai koncept akoma nuk është futur në agjendën e Qeverisë për shkak të ngarkesave që ka pasur Qeveria në fundvit. Mirëpo ata kanë marrë premtim nga Qeveria se së shpejti ky koncept dokument do të miratohet dhe ata do të mund të fillojnë me amendamentimin e Ligjit për të verbëritë. Lidhur me përmbajtjen e këtij koncept- dokumenti ajo tha se janë paraparë zgjidhja e atyre problemeve me të cilat ballafaqohen dhe sipas parashikimeve të tyre amendamenti i ligjit duhet të përfundojë më 30 qershor 2014.

Kryetarja – Theksoi se në kohën e arritjes së projektligjit në Kuvend ka pasur vështirësi të mëdha, sepse në bazë të deklaratës financiare është konstatuar se ky ligj nuk do të mund të zbatohet, por pas takimeve që janë bërë më Ministrin e Financave Komisioni ka marrë premtimin që do të sigurohen të holla në mënyrë që të mund të implementohet ky ligj. Ajo tha se edhe Komisioni Mediko – Social është formuar me vonesë, sepse Ligji është miratuar në korrik të vitit 2012 dhe ka pasur gjashtë muaj kohë që të nxirren aktet nënligjore ndër të cilat ka qenë edhe formimi i këtij Komisioni. Ajo kërkoi informacione nga të ftuarit lidhur me përmbajtjen e koncept- dokumentit.

Minire Begaj – Tha se gjatë kohës së hartimit të këtij koncept- dokumenti kanë respektuar procedurat dhe lidhur me këtë ata kanë kërkuar edhe ndihmën e aktorëve të cilët mund të ofrojnë ndihmë në këtë drejtim duke i specifikuar shoqatat e të verbërve, dhe si çështje të diskutueshme në këtë koncept dokument ajo tha se ka qenë neni 7 që ka të bëjë me shoqëruesin, sepse pak flitet për shoqëruesin e personit të verbër. Ajo tha se në këtë koncept- dokument ata kanë caktuar disa kritere edhe për shoqëruesin sepse është e nevojshme që të caktohen disa kritere edhe për shoqëruesin sepse në praktike kanë hasur në probleme edhe për këtë çështje. Pastaj ajo përmendi nenin 3 që sipas saj është mjaft kontestues, sepse në bazë të atij neni të verbërve i ka përjashtuar personat e verbër nga skemat e tjera pensionale dhe për këtë arsye ka pasur probleme, sepse nuk mund t'i mohohet realizimi i pensionit për shkak se realizohet kompensimi për shkak të verbërisë.

Kryetarja – Ishte e pajtimit me vendosjen e kritereve për përcjellësit e personave të verbër, sepse siç tha ajo nuk mund të jetë përcjellës i personit të verbër një person me

aftësi të kufizuar, por duhet të jetë personi i cili i plotëson kriteret. Lidhur me kompensimet në të holla për vitin 2013, ajo pyeti se si do të veprojë ministria në këtë rast.

Nexhat Syla – Lidhur me këtë çështja tha se gjatë vitit 2013 Ministrinë e Punës e kanë përcjellë disa vështirësi buxhetore. Ai tha se shumë herë u janë drejtuar institucioneve kompetente për kërkesa shtesë në buxhet, sepse kjo ka qenë e nevojshme. Ai theksoi se gjatë vitit 2013 MPMS-ja ka pasur një mungesë prej 10 milionë euro. Sa i përket çështjes së kompensimit të personave të verbër ai tha se gjatë rishikimit të buxhetit ata kanë kërkuar disa transferime të brendshme për t'i mbuluar skemat e pensioneve me aftësi të kufizuara sepse nuk kanë pasur mjete të mjaftueshme. Ai tha se i janë drejtuar me shkresë Komisionit për Buxhet në të cilën shkresë e kanë sqaruar se mjetet për persona të verbër nuk mjaftojnë. Në vazhdim ai tha se nga z. Agim Krasniqi kanë marrë përgjigje se janë ndarë 1. 590000 euro për kategorinë e personave të verbër, mirëpo janë alokuar në programin 002 që i takon personave me aftësi të kufizuar. Ai i informoi se nuk kanë pasur mundësi ligjore që të bëjnë pagesa të personave të verbër nga programi i personave me aftësi të kufizuara sepse nuk ka pasur program të veçantë siç është në vitin 2014. Kurse sa i përket vitit 2014 ai tha se janë 1.8 milion euro që realizohen ndaj 1201 përfituesve, kurse ju nevojitet buxhet shtesë për të realizuar pjesën e kompensimeve për vitin 2013. Ai në fund tha se me gjendjen aktuale siç është e kanë të pamundur që të bëjnë pagesat retroaktive të personave të verbër.

Kymete Bajraktari – Shfaqti pakënaqësinë e mos prezencës së ministrit, pasi që Komisioni ka kërkuar që ai të jetë prezent në takim dhe të japë sqarimet e kërkuara. Ajo e ngriti sërish çështjen e mos pagesës retroaktive për vitin 2013. Ajo theksoi se me rishikimin e buxhetit janë alokuar mjetet nga Ministria e Financave në Ministrinë e Punës për t'i realizuar pagesat ndaj personave të verbër për vitin 2013. Ajo në vazhdim i njoftoi se ka kontaktuar me z. Agim Krasniqi nga Ministria e Financave dhe është informuar se 1.4 milionë euro janë ndarë për kategorinë e personave të verbër dhe për shkak të mos ekzistimit të kodit të veçantë kanë mbetur pa u realizuar dhe me rishikimin e buxhetit kanë mbetur që të realizohen në mënyrë retroaktive 1.590000 me qëllim të zbatimit të Ligjit për personat e verbër. Ajo, po ashtu, i informoi se ka kontaktuar edhe me kryetaren e Komisionit për Buxhet znj. Safete Hadërgjonaj e cila ka tentuar që me një nënkod të veçantë të futen këto mjete. Ajo tha se kjo shumë ka qenë e ndarë ekskluzivisht për personat e verbër dhe jo për personat e tjerë me aftësi të kufizuara. Ajo i përmendi vonesat në nxjerrjen e akteve nënligjore dhe formimin e Komisionit Mediko – Social të cilat kanë ndikuar negativisht në zbatimin e Ligjit për personat e verbër. Në fund ajo pyeti se ku saktësisht janë mjetet të cilat janë ndarë për kompensimin e personave të verbër.

Nexhat Syla – Theksoi se ata kanë kërkuar transferimin e 1.5 milion euro në kodin për personat me aftësi të kufizuar në të cilin kanë përfituar edhe personat e verbër. Ai tha se është jo logjike të thuhet se ato mjete kanë humbur, sepse janë raportet që tregojnë se si janë shpenzuar ato mjete. Ai tha se ato janë shpërndarë personave me aftësi të kufizuar për shkak se destinomi i tyre ka qenë në kodin 002 që i përket personave me aftësi të

kufizuar dhe ata e kanë pasur të pamundur t'i paguajnë vetëm personat e verbër dhe t'i lënë pa kompensim personat e tjerë me aftësi të kufizuar.

Kymete Bajraktari – Duke u ndërlidhur theksoi se me rishikim të buxhetit janë paraparë rreth 1. 590000 milion euro për kompensimin e personave të verbër, mirëpo kjo gjë nuk është duke u realizuar dhe kërkoi që kjo të bëhet sa më shpejt, sepse mjetet janë ndarë për këtë çështje.

Minire Begaj – Tha se kanë pasur shumë takime edhe me Shoqatën për të verbrit me qëllim të gjetjes se një zgjidhje, mirëpo është e pamundur pasi që nuk ka mjete financiare. Duke marrë parasysh kategoritë e tjera që janë bazë, ajo tha se është e pamundur një realizim i tillë në kushtet aktuale.

Kryetarja pyeti se a i kanë marrë shumën prej 1.590000 euro pas rishikimit të buxhetit.

Sami Salihu – Theksoi se kategoria e personave të verbër kanë qenë shfrytëzues të skemës për personat me aftësi të kufizuar. Në këtë mënyrë ata kanë marrë një pjesë të të ardhurave. Tani duhet vetëm të bëhet kompensimi i pjesës së mbetur.

Rita Hajzeraj – Beqaj – Duke u ndërlidhur tha se ligji duhet të zbatohet në tërësi, e jo vetëm pjesërisht. Lidhur me zbatimin e ligjeve nga Qeveria ajo theksoi se Qeveria nuk është fare e interesuar që t'i zbatojë ligjet që i miraton Kuvendi. Ajo, po ashtu, tha se në kohen kur është miratuar ky ligj ministri është dashur që ta refuzojë në seancë me arsyetimin se nuk ka mjete dhe ligji i tillë nuk do të mund të zbatohet. Fakt tjetër me rëndësi që ajo përmendi ishte ridestinimi i rreth 1.5 milion euro për këtë kategori me rishikim të buxhetit dhe është dashur që ajo shumë të shpërndahet pikërisht për personat e verbër.

Kurtan Kajtazi – Theksoi se gjatë kohës së shqyrtimit dhe miratimit të këtij ligji ka qenë dëshirë e të gjithëve që kompensimi të jetë sa më i madh, mirëpo mundësitë buxhetore nuk kanë lejuar shumë më të madhe se sa ajo që është paraparë në ligj. Ministria e Punës është sfiduar në një farë mënyrë nga ana e Kuvendit, sepse ata kanë deklaruar se për këtë çështje nuk ka mjete buxhetore dhe nuk mund të zbatohet një ligj i tillë me atë kosto financiare. Problematikë tjetër që ka ndikuar në moszbatim të ligjit ka qenë edhe numri më i madh se sa ai i parashikuar i personave të verbër. Ai përmendi disa çështje me rëndësi rreth amendamentimit të ligjit duke potencuar se duhet të ndryshohet pjesa e ligjit ku e ndalon kompensimin në mënyra të tjera të personave të verbër. Lidhur me këtë ai pyeti se a ka përfunduar punën e tij Komisioni Mediko – Social në kategorizimin e personave të verbër apo akoma është në vazhdim të punës.

Minire Begaj - Theksoi se problemet e tilla janë identifikuar nga analizat e MPMS-së në Ligjin e personave të verbër dhe lidhur me këtë kanë paraqitur shqetësimet e tyre që me zbatim të ligjit në këtë mënyrë po shkelen të drejtat e atyre personave të realizimi i beneficioneve të tjera. Dhe kjo është diskutuar edhe në Qeveri që këto të drejta shkelen dhe si do të veprohet në këto raste.

Bujar Kadriu – Duke u ndërlidhur tha se nuk është e vërtetë që ligji është miratuar pa deklaratë financiare dhe theksoi se sponsoruesi i ligjit para se të miratohet ky ligj ka marrë nga Shoqata e të verbërve listën e personave të verbër dhe në këtë mënyrë deklarata financiare ka shkuar me 1.4 milion euro që do të thotë se Qeveria ka përgatitur ligjin me 1.4 milion euro kosto financiare. Ai i njoftoi se këtë shumë e ka miratuar edhe Komisioni për Buxhet i Kuvendit të Kosovës dhe ky ligj ka kaluar nëpër të gjitha procedurat që i parasheh Kuvendi për miratim të një ligji. Në vazhdim ai tha se ky ligj ka kaluar edhe nëpërmes zyrës ligjore të Ministrisë së Punës dhe në një takim udhëheqësi i atëhershëm i asaj zyre ka thënë se personat e verbër nuk kanë të drejtë të gëzojnë skemat e tjera pensionale dhe në atë rast është bërë një shkelje që sipas mendimit të tij ka ndodhur për shkak të një keqinterpretimi të ligjit. Ai ishte i pajtimit që personat e verbër të mos jenë shfrytëzues të pensionit të personave me aftësi të kufizuar, sepse e shfrytëzojnë kompensimin për shkak të verbërisë që jepet në bazë të Ligjit për personat e verbër. Ai në vazhdim e përmendi nenin 11.2 të Rregullores së Komisionit Mediko – Social sipas të cilit personat e verbër që e gëzojnë pensionin e personave me aftësi të kufizuar do ta marrin edhe pjesën shtesë që i takon në bazë të ligjit për personat e verbër me qëllim të nivelizimit të të ardhurave që duhet të ju takojnë personave të verbër në bazë të ligjit për këta persona. Ai po ashtu theksoi se me rishikimin e buxhetit kur është bërë ka marrë informacione nga deputetet se është ndarë shuma e caktuar dhe puna është kryer/ Lidhur me këtë çështje ai tha se personat e verbër dëshirojnë të dinë se kur do të bëhet pagesa ndaj personave të verbër që ka qenë e paraparë të realizohet në vitin 2013 dhe nuk është realizuar akoma. Në fund ai kërkoi një afat brenda të cilit do të bëhet ai kompensim ose në të kundërtën ai tha se do t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese nëpërmes Avokatit të Popullit, apo nëpërmes deputetëve për të dhënë mendim rreth zbatueshmërisë së Ligjit për personat e verbër.

Kimete Bytyqi – Pyeti se sa ka qenë e drejtë që mjetet e ndara për personat e verbër të shpenzohen në drejtime të tjera, dhe në fund ajo theksoi se ajo ka njohuri se ka ngritje të buxhetit dhe si është e mundur që kjo ministri mos të ketë mjetet të mjaftueshme.

Nexhat Sylja – E sqaroi edhe njëherë mënyrën e realizimit apo shpenzimit të këtyre mjeteve duke theksuar se mjetet janë ndarë në kodin 002 që i dedikohet personave me aftësi të kufizuar dhe ata e kanë pasur të pamundur që t'i realizojnë pagesat vetëm për personat e verbër.

Justina Pula Shiroka – Duke u ndërlidhur theksoi se në ato rrethana kur mjetet vendosen në një kod dhe nuk definohet se për çka do të shërbejnë atëherë ato mjete do të shpërndahen sipas kategorizimit që është brenda atij kodi dhe në këtë rast ka qenë kategorizimi i personave me aftësi të kufizuar brenda të cilëve kanë qenë edhe personat e verbër. Pas një kohë lidhur me këtë çështje ka ardhur njoftimi se për çka janë të dedikuara ato mjete, mirëpo deri në atë kohë ka qenë një vakum në të cilin zyrtarët e MPMS nuk kanë mundur të veprojnë ndryshe.

Albana Gashi – Duke u ndërlidhur theksoi se ligji është miratuar në vitin 2012, pasi që mjetet nuk janë ndarë në atë vit ky ligj ka hyrë në fuqi më 1 janar të vitit 2013, mirëpo

edhe pse ka hyrë në fuqi në këtë kohë prapë nuk janë ndarë mjete për zbatimin e këtij ligji. Në vazhdim ajo tha se sipas informatave që ka MPMS-ja nuk ka bërë kërkesë që të krijohet një linjë e veçantë buxhetore për këtë kategori dhe pikërisht për këtë shkak ka ardhur deri te komplikimi i situatës dhe mosrealizimi i këtyre mjeteve ndaj personave të verbër gjatë tërë vitit 2013. Ajo tha se në bazë të kërkesave që ka pasur Ministria e Financave i ka ndarë mjetet buxhetore, por i ka vendosur në një kod tjetër, pasi që nuk ka pasur kod të veçantë për këtë kategori dhe kështu ka ndodhur problemi që nuk janë realizuar këto mjete në vitin 2013, ajo tha se për këtë është faj i MPMS por mund të jetë edhe te Ministria e Financave. Ajo në fund theksoi se në vazhdimësi është shkelur Ligji për personat e verbër duke filluar nga nxjerrja e akteve nënligjore dhe formimi i Komisionit Mediko – Social. Dhe mosrealizimi i këtyre kompensimeve ndaj personave të verbër është shkelje e ligjit nga ana e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Minire Begaj – Duke u ndërlidhur tha se nuk janë duke e shkelur ligjin. Ajo i informoi se ata disa herë kanë kërkuar nga të gjitha instancat që të bëhet ndarja e mjeteve buxhetore për këtë kategori dhe për këtë ajo tha se kanë fakte dokumentet që i kanë dërguar. Sa i përket vonesës së nxjerrjes së akteve nënligjore ajo tha se MPMS ka pasur për të nxjerrë dy akte nënligjore dhe këto i ka nxjerrë me kohë dhe ka pasur mundësi që ta bëjë ndryshimin dhe plotësimin e tyre, kurse aktet e tjera nënligjore ajo tha se janë kompetencë e institucioneve të tjera.

Justina Pula -Shiroka – Duke u ndërlidhur me konceptin e dokumentit theksoi e ri sipas të cilit do të ndërrohet edhe skema aktuale, dhe ajo kërkoi që të gjithë së bashku të jenë më azhur në mënyrë që të arrijë deri te realizimi i qëllimit, përndryshe nëse nuk bëhet kështu ajo tha se do të përsëritet situata me problemet e njëjta dhe nuk do të ketë mënjanim të problemeve.

Pas një debati lidhur me këtë çështje Komisioni mori vendim që ta nxjerrë një rekomandim me të cili do të rekomandohet zbatimi i Ligjit për personat e verbër në mënyrë që të realizohet kompensimi i të hollave të personat e verbër për vitin 2013.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21. 1. 2014

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 21. 1. 2014 nuk u miratua për shkak se nuk ka arritur të përkthehet në gjuhën serbe dhe i njëjti do të miratohet në takimin e radhës,
Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

4. Miratimi i Raportit të punës së Komisionit për vitin 2013

Kryetarja i njoftoi anëtarët e Komisionit se lidhur me raportin e punës së Komisionit e kanë pasur një plotësim i cili është përfunduar.

Pas një debati lidhur me këtë Komisioni nxori:

V E N D I M

Miratohet Raporti Vjetor i Punës së Komisionit për vitin 2013.

5. Miratimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2014

Kryetarja i njoftoi anëtarët e Komisionit se para takimit OSBE-ja i ka njoftuar se do ta përkrahë Komisionin në zbatimin e rekomandimeve që kanë të bëjnë me Ligjin për Avokatin e Popullit, si dhe Ligjin kundër Diskriminimit. Po ashtu është futur edhe mbikëqyrja e buxhetit të institucioneve të pavarura.

Pas shqyrtimit të këtyre çështjeve Komisioni mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Plani i Punës së Komisionit për vitin 2014.

6. Formimi i Panelit Rekrutues për rekrutimin e kandidateve për zgjedhjen e Avokatit të Popullit

Kryetarja tha se në Panelin rekrutues duhet të jenë shtatë anëtarë, një anëtar për secilën parti politike. Ajo i informoi anëtarët se si do të veprojnë gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, si dhe intervistimit të kandidatëve të cilët do i plotësojnë kushtet.

Pas një debati lidhur me këtë çështje Komisioni nxori këtë:

V E N D I M

I. Formohet Paneli për intervistimin e kandidatëve për pozitën e Avokatit të Popullit me këtë përbërje:

1. Suzana Novoberdaliu – Kryesuese,
2. Rita Hajzeraj – Beqaj – Anëtare,
3. Kurtan Kajtazi – Anëtar
4. Biserka Kostic – Anëtare,
5. Duda Balje – Anëtare,
6. Albana Gashi - Anëtare,

7. Kymete Bajraktari – Anëtare.

- II.** Paneli rekrutues ka për detyrë shqyrtimin e dokumentacionit të kandidatëve, si dhe intervistimin e kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet e parapara me konkurs. Po ashtu paneli ka për detyrë që Komisionit t’ia përcjellë Raportin me tre kandidatët më të suksesshëm gjatë intervistimit.

7. Të ndryshme

Kryetarja e njoftoi Komisionin se ka ardhur një përfundim i Kryesisë së Kuvendit që ta shqyrtoj shkresën për laureatën e çmimit të OKB-së për të drejtat e njeriut e cila i është ndarë zonjës me aftësi të kufizuara Hilmijeta Apuk dhe ta paraqesin këtë çështje në Seancë Plenare. Ajo tha se do ta paraqet këtë në Seancë Plenare të radhës, sepse nuk është praktikë që në personat e tjerë t’i drejtohen Kuvendit përveç deputetëve.

Kimete Bytyqi – Bëri vërejtje që kur të ketë ndonjë datë të rëndësishme sikurse që ishte përvjetori i vdekjes së Presidentit Ibrahim Rugova të mos ketë aktivitete në Komision sepse disa nga deputetët nuk mund të ndjekin takimet e Komisionit, si dhe aktivitetet e tjera për hir të këtyre datave.

Kryetarja – Bëri sqarime se në ditët që janë ditë pune nuk ka arsye që mos të ketë aktivitete në Komision, sepse nuk është e përcaktuar me ligj si ditë në të cilën nuk punohet.

Kurtan Kajtazi – Theksoi se është mirë që vizitat që realizohen jashtë vendit të raportohen në Komision për qëllimin e realizimit të asaj vizite, si dhe rezultatet që janë arritur në vizita sepse vitin e kaluar janë realizuar 5 vizita jashtë shtetit dhe asnjëherë nuk është raportuar dhe nuk kanë njohuri se çka ka ndodhur dhe cili ka qenë qëllimi i atyre vizitave.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdali